

MARRËVESHJE

midis

**Ministres Federale të Punëve të Brendshme të Republikës së Austrisë
dhe**

Ministrit të Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës

mbi bashkëpunimin policor

Ministrja Federale e Punëve të Brendshme e Republikës së Austrisë dhe Ministri i Punëve të Brendshme i Republikës së Kosovës,

të quajtura në vazhdim palët kontraktuese,

me qëllim për të dhënë kontribut në zhvillimin e marrëdhënieve dypalëshe,

të vetëdijshme për rëndësinë e mbështetjes së bashkëpunimit në luftën ndaj krimet ndërkombëtar,

të shqetësuara prej rrezikut të përhapjes së tregtimit ilegal të drogave, të substancave psikotrope dhe të lëndëve të para të drogave si edhe të formave të tjera të krimet ndërkombëtar që vënë në rrezik sigurinë ose interesa të tjera thelbësore të të dy shteteve,

me synim të koordinojnë aktivitetet e tyre në luftë kundër krimet ndërkombëtar të organizuar dhe migracionit ilegal,

duke u nisur nga Konventa e Vetme për Drogat Narkotike e datës 30 mars 1961 në versionin e protokollit të datës 25 mars 1972, me të cilin u ndryshua Konventa e Vetme për Drogat Narkotike, nga Konventa për Substancat Psikotrope e datës 21 shkurt 1971, Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe të Substancave Psikotrope e datës 20 dhjetor 1988 si edhe nga Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimet të Organizuar Ndërkombëtar e datës 15 nëntor 2000 dhe nga tre Protokollat Shtesë,

ranë dakord si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi dhe fushat e bashkëpunimit

Palët kontraktuese angazhohen të bashkëpunojnë dhe të japin ndihmë zyrtare në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar dhe në kuadrin e kompetencave të tyre në mbrojtjen kundër rreziqeve për sigurinë dhe rendin publik si edhe në parandalimin dhe zbulimin e veprave penale të dënueshme nga ana e gjykatave. Ky bashkëpunim përfshin sidomos fushat e mëposhtme:

1. mbjelljen ilegale, prodhimin, importin, eksportin ilegal, transportin dhe tregtimin ilegal të drogave narkotike, të substancave psikotrope dhe të lëndëve të para të drogave;
2. terrorizmin ndërkombëtar;
3. veprat penale kundër jetës, paprekshmërisë trupore dhe lirisë personale, trafikimin e migrantëve dhe migracionin ilegal, tregtinë e qenieve njerëzore, krimin kundër pronës, krimin ekonomik, korrupsionin, larjen e parave, krimin e falsifikimit, krimin ndaj mjedisit dhe forma të tjera të krimit ndërkombëtar të organizuar duke përfshirë edhe hetimet në lidhje me vendndodhjen ku kanë mbetur fitimet dhe vlerat pasurore.

Neni 2

Format e bashkëpunimit

(1) Bashkëpunimi i palëve kontraktuese sipas kësaj marrëveshjeje bëhet në përputhje me legjislacionin kombëtar përkatës si edhe në kuadrin e fushës përkatëse të kompetencës dhe përfshin sidomos

1. informimin reciprok në rast se ekzistojnë njohuri, që mund të kontribuojnë për mbrojtjen kundër rreziqeve për sigurinë dhe rendin publik si edhe për parandalimin dhe zbulimin e veprave penale të dënueshme nga ana e gjykatave; transmetimi i të dhënave personale lejohet vetëm në se kjo është e nevojshme për mbrojtjen kundër rreziqeve të përmendura si edhe për zbulimin e veprave të përmendura;
2. përkrahjen reciproke në kërkimin e personave, në kërkimin e sendeve, në konstatimin (përcaktimin) e personave dhe identifikimin e kufomave;
3. realizimin e masave policore të koordinuara të palëve kontraktuese mbi territorin e tyre për mbrojtjen kundër rreziqeve për sigurinë dhe rendin publik si edhe për parandalimin dhe zbulimin e veprave të dënueshme nga ana e gjykatave;
4. ndihmën e ndërsjelltë në luftën ndaj migracionit ilegal, sidomos kur ka të bëjë me nënshtetasit e palëve kontraktuese, si edhe krijimin e masave të nevojshme organizative në ato raste të nevojshme për këtë;
5. identifikimin dhe kthimin mbrapsht apo marrjen (pranimin) mbrapsht të shtetasve të palëve kontraktuese, të cilët qëndrojnë/janë futur në mënyrë të paligjshme;
6. shkëmbimin e përvojave në lidhje me zbatimin e akteve ligjore, parandalimin e krimit si edhe metodat, mjetet dhe teknikat e aplikuara të kriminalistikës;
7. shkëmbimin e përvojave të ekspertëve në luftimin e disa fushave të caktuara të krimit dhe migracionit ilegal si dhe organizimin e takimeve të ekspertëve.

(2) Palët kontraktuese mbështesin njëra tjetrën mbi bazën e një kërkesë.

(3) Informacionet sipas pikës 1 dhe 7 të paragrafit 1 i jepen palës tjetër kontraktuese nga çdo palë kontraktuese në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar edhe pa kërkesë, në se ekzistojnë arsye konkrete se njohja e tyre është e nevojshme për palën tjetër kontraktuese për mbrojtjen kundër rreziqeve për sigurinë dhe rendin publik ose për parandalimin dhe zbulimin e veprave penale të dënueshme nga ana e gjykatave. Palët kontraktuese mbështesin njëra-tjetrën në këtë mënyrë sidomos kur kryhet ose përgatitet një vepër penale në territorin e palës tjetër kontraktuese

dhe ka informacione se ekziston një lidhje me territorin shtetëror të palës tjetër kontraktuese.

- (4) Realizimi i bashkëpunimit midis palëve kontraktuese mund të bëhet edhe nëpërmjet oficerëve ndërlidhës. Oficeri ndërlidhës kryen veprimtari të informimit dhe të këshillimit dhe nuk ka kompetenca ekzekutive. Detyrat e oficerit ndërlidhës caktohen nga autoritetet kompetente në përputhje me legjislacionin kombëtar.

Neni 3 Autoritetet kompetente

- (1) Palët kontraktuese informojnë njëra-tjetrën nëpërmjet autoriteteve që sipas legjislacionit kombëtar përkatës janë kompetente për bashkëpunimin e parashikuar në këtë marrëveshje, dhe ato informojnë njëra-tjetrën për ndryshimet e kompetencës ose të emërimit.
- (2) Shkëmbimi i informacioneve midis palëve kontraktuese në kuadrin e Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (Interpol) mund të plotësohet në përputhje me legjislacionin kombëtar nëpërmjet kontakteve direkte midis shërbimeve kompetente të specializuara.

Neni 4 Përmbajtja, Forma dhe transmetimi i Kërkesës

- (1) Kërkesat përmbajnë
1. emërtimin e autoritetit kompetent që paraqet kërkesën dhe emërtimin e autoritetit kompetent, të cilit i drejtohet kërkesa;
 2. lëndën e kërkesës;
 3. qëllimin dhe argumentimin e kërkesës;
 4. tërësinë e provave;
 5. përshkrimin e veprës që përbën lëndën e kërkesës, dhe kualifikimin juridik të kësaj vepre;
 6. afatin për përmbushjen e kërkesës si dhe argumentimin e urgjencës;
 7. të dhënat, në vëllimin e duhur për plotësimin e kërkesës, për identitetin e personit që ka lidhje me veprën, aq sa dihen;
 8. të gjitha të dhënat e tjera që i shërbejnë çështjes, të cilat janë të dobishme për plotësimin efektiv të kërkesës.
- (2) Në se autoriteti kompetent i palës kontraktuese tek e cila drejtohet kërkesa ka nevojë për informacione të tjera për plotësimin e kërkesës, ai mund t'i kërkojë ato tek autoriteti kompetent i palës kontraktuese që bën kërkesën.
- (3) Kërkesa dhe plotësimi i saj bëhen parimisht me shkrim. Në raste urgjente kërkesa dhe përmbushja e saj mund të bëhen edhe gojarisht pasuar pa vonesë me vërtetim me shkrim. Në rast se ekziston dyshim për autenticitetin ose përmbajtjen e kërkesës, mund të kërkohet vërtetim tjetër.
- (4) Kërkesa bëhet në gjuhën e palës kontraktuese që bën kërkesën duke i bashkangjitur një përkthim në gjuhën e palës kontraktuese tek e cila drejtohet

kërkesa ose në gjuhën angleze. Në formën përkatëse kjo vlen edhe për përmbushjen (përgjigjen) e kërkesës.

Neni 5

Mbrojtja e të dhënave personale

Transmetimi i ndërsjelltë i të dhënave personale (të quajtur në vazhdim: të dhënat) midis palëve kontraktuese bëhet në përputhje me legjislacionin kombëtar përkatës duke respektuar kushtet e caktuara nga ana e autoritetit dërgues dhe në përputhje me parimet e mëposhtme që u aplikohen në të njëjtën mënyrë të dhënave të përpunuara me ose pa ndihmën e kompjuterit:

1. Të dhënat e transmetuara duhet të jenë nxjerrë besnikërisht në mirëbesim dhe në mënyrë të ligjshme dhe po ashtu duhet të përpunohen. Ato duhet të jenë të regjistruara për qëllime të përcaktuara dhe të ligjshme dhe nuk lejohet të përdoren në asnjë mënyrë, që është e papajtueshme me këto qëllime. Ato duhet t'i përgjigjen qëllimeve për të cilat janë regjistruar, të jenë të qenësishme (rëndësishme) për këto qëllime dhe nuk lejohet t'i tejkalojnë ato.
2. Të dhënat që japin të kuptohet origjina racore, pikëpamjet politike apo fetare ose bindje të tjera, si edhe të dhëna që kanë të bëjnë me shëndetin ose jetën seksuale, lejohet të përpunohen vetëm në rast se legjislacioni kombëtar garanton një mbrojtje të përshtatshme. E njëjta gjë vlen edhe për të dhënat mbi dënime penale nga gjykatat.
3. Pa marrë paraprakisht autorizimin e autoritetit dërgues nuk lejohet që të dhënat e transmetuara të përdoren për qëllime të tjera përveç qëllimeve për të cilat u transmetuan. Një autorizim i tillë mund të jepet vetëm në se legjislacioni kombëtar i palës kontraktuese që disponon këto të dhëna lejon një përdorim për qëllime të tjera.
4. Të dhënat e transmetuara duhet të fshihen ose të korrigojnë në momentin që
 - a) këto të dhëna rezultojnë të pasakta ose në përpunimin zyrtar ose në bazë të një njoftimi të personit të cilit i referohen të dhënat, ose
 - b) autoriteti dërgues informon se të dhënat e transmetuara janë gjetur ose transmetuar në mënyrë të paligjshme, ose sipas legjislacionit kombëtar të autoritetit dërgues të dhënat e transmetuara në mënyrë të ligjshme duhet të fshihen më vonë pas një afati të caktuar, ose
 - c) të dhënat nuk nevojiten më për plotësimin e detyrës së autoriteteve për të cilën janë transmetuar me përjashtim të rasteve kur ekziston një autorizim i shprehur qartë se të dhënat e transmetuara mund të përdoren për qëllime të tjera.
5. Në se autoriteti dërgues kompetent i një pale kontraktuese e kërkon, autoriteti marrës duhet të informojë mbi çdo përdorim të të dhënave të marra.
6. Autoriteti dërgues kompetent siguron saktësinë dhe aktualitetin e të dhënave të transmetuara dhe është i detyruar të marrë parasysh nevojën dhe proporcionalitetin lidhur me qëllimin e ndjekur me transmetimin dhe të kujdeset për respektimin e ndalimeve të transmetimit sipas legjislacionit kombëtar përkatës. Kur del se u transmetuan të dhëna të pasakta ose të dhëna që nuk duhej të transmetoheshin

ose disa të dhëna të transmetuara në mënyrë të ligjshme që sipas legjislacionit të shtetit të autoritetit dërgues duhet të fshihen më vonë në një afat të caktuar, autoriteti marrës duhet menjëherë të informohet mbi këtë. Nga ana e tij ky i fundit duhet të ndërmarrë menjëherë fshirjen ose korrigjimin e nevojshëm.

7. Në se autoriteti marrës ka arsye të supozojë se disa të dhëna të transmetuara janë të pasakta ose duhet të fshihen, ai informon menjëherë autoritetin dërgues mbi këtë.
8. Palët kontraktuese përkujdesen që për transmetimin e të dhënave të përdoren vetëm mjete të komunikimit që sigurojnë një mbrojtje të përshtatshme të të dhënave kundër njohjes ose ndryshimit të paligjshëm nga të tretët gjatë procesit të transmetimit.
9. Autoriteti marrës është i detyruar t'i mbrojë të dhënat e transmetuara në mënyrë të efektshme kundër prishjes së rastësishme ose të paautorizuar, humbjes së rastësishme, ndryshimit ose transmetimit të mëtejshëm të paautorizuar ose të rastësishëm, hyrjes së paautorizuar dhe publikimit të paautorizuar.
10. Autoriteti dërgues dhe marrës janë të detyruar të dokumentojnë dërgimin, marrjen dhe asgjësimin e të dhënave. Dokumentacioni përmban arsyen e dërgimit, përmbajtjen, autoritetin dërgues dhe autoritetin marrës, momentin e transmetimit si edhe të asgjësimit të të dhënave. Këto shënime duhet të mbrohen nëpërmjet masave të përshtatshme kundër përdorimit për qëllime të tjera dhe një shpërdorimi tjetër dhe duhet të ruhen tre vjet. Pas këtij afati duhet të fshihen menjëherë. Të dhënat e dokumentacionit lejohen të përdoren vetëm për kontrollin e respektimit të dispozitave ligjore të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave.
11. Çdo person, të cilit i referohen të dhënat, ka të drejtë, duke dëshmuar identitetin e tij dhe në bazë të një kërkesë, të marrë në një formë përgjithësisht të kuptueshme dhe pa vonesë të paarsyeshme informacione nga autoriteti përgjegjës për përpunimin mbi të dhënat e transmetuara ose të përpunuara në lidhje me të në kuadrin e kësaj marrëveshjeje, origjinën e tyre, marrësit e mundshëm dhe kategoritë e mundshme të marrësve, qëllimin e parashikuar të përdorimit dhe bazën ligjore, dhe të drejtë për korrigjim të të dhënave të pasakta dhe për fshirjen e të dhënave të përdorura në mënyrë të palejuar. Përveç kësaj palët kontraktuese sigurojnë që i interesuari në rast të cenimit të të drejtave të tij për mbrojtjen e të dhënave të ketë mundësi t'i drejtohet me një ankesë të efektshme një gjykatë të pavarur dhe të paanshme të bazuar në ligj sipas paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore (Konventa Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut) dhe që t'i jepet mundësia të kërkojë nëpërmjet një gjykatë një dëmshpërblim ose një formë tjetër kompensimi legal. Detajet e procedurës për realizimin e këtyre të drejtave varen nga legjislacioni kombëtar i palës kontraktuese tek e cila është bërë kërkesa. Palët kontraktuese sigurojnë në këtë rast të paktën një nivel mbrojtjeje siç rezulton nga Konventa nr. 108 e Këshillit të Evropës mbi Mbrojtjen e Njeriut në Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale, nga protokollin shtesë i datës 8 nëntor 2001 si edhe nga rekomandimi nr. R (87) 15 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës i datës 17 shtator 1987 për rregullimin e përdorimit të të dhënave personale nga ana e policisë duke përfshirë edhe të dhënat që nuk përpunohen në mënyrë të automatizuar. Në rast të një kërkesë për marrjen parasysh të këtyre të drejtave autoriteti që disponon të dhënat i jep

autoritetit dërgues mundësinë të paraqesë pozicionin e tij para se të marrë një vendim mbi kërkesën.

Neni 6 Ruajtja e sekretit

Informacionet e transmetuara për qëllimet e kësaj marrëveshjeje i nënshtrohen parimisht sekretit zyrtar. Pala kontraktuese që merr informacione sipas kësaj marrëveshjeje siguron për këto të paktën një ruajtje sekrete të barazvlefshme me atë të palës kontraktuese dërguese.

Neni 7 Konsultimet

Në rast nevoje nëpunës drejtues të palëve kontraktuese mund të bëjnë konsultime për të shqyrtuar mjete dhe rrugë për aplikimin efektiv të kësaj marrëveshjeje si edhe masa të mundshme për zhvillimin e mëtejshëm dhe përmirësimin e bashkëpunimit.

Neni 8 Kufizimi i bashkëpunimit

- (1) Në se një palë kontraktuese është e mendimit se përmbushja e një kërkesë ose një lloj tjetër bashkëpunimi mund të cenonte sovranitetin e saj, sigurinë e saj, rendin e saj publik ose interesa të tjera thelbësore të vendit të saj ose mund të shkelte parime të legjislacionit të saj kombëtar, ajo mund të refuzojë plotësisht ose pjesërisht bashkëpunimin (mbështetjen) e saj ose ta lidhë me plotësimin e disa kushteve.
- (2) Pala kontraktuese që ka bërë kërkesën duhet të informohet mbi vendimin duke i dhënë arsyet.

Neni 9 Shpenzimet

Çdo palë kontraktuese mbulon vetë shpenzimet që i rezultojnë asaj nga aplikimi i kësaj marrëveshjeje.

Neni 10 Raporti me marrëveshjet e tjera ndërkombëtare

Nga dispozitat e kësaj marrëveshjeje nuk preken të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese nga marrëveshjet e tjera ndërkombëtare.

Neni 11

Interpretimi i marrëveshjes

- (1) Mosmarrëveshjet mbi interpretimin ose aplikimin e kësaj marrëveshjeje zgjidhen nëpërmjet negociatave direkte midis palëve kontraktuese.
- (2) Në se nuk arrihet një zgjidhje nëpërmjet negociatave sipas paragrafit 1, çështja do të zgjidhet në rrugë diplomatike.

Neni 12

Hyrja në fuqi, ndryshimet dhe denoncimi

- (1) Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të tretë pas momentit kur palët kontraktuese informojnë njëra-tjetrën mbi plotësimin e kushteve kombëtare përkatëse të nevojshme për këtë.
- (2) Kjo marrëveshje lidhet nga të dyja palët për një kohëzgjatje të pacaktuar. Me mirëkuptim me shkrim të dyanshëm mund të bëhen ndryshime në këtë marrëveshje.
- (3) Kjo marrëveshje mund të denoncohet me shkrim nga secila palë kontraktuese në rrugë diplomatike. Denoncimi hyn në fuqi ditën e parë të muajit të dytë, që pason muajin e marrjes së njoftimit nga pala tjetër kontraktuese.

Bërë në Pristina, më 12.08.2009

në dy ekzemplarë origjinalë, në gjuhën gjermane, shqipe dhe serbe, ku të gjithë tekstet janë njësoj autentikë.

Ministrja Federale e Punëve të Brendshme
e Republikës së Austrisë

Maria Fekter m.p.

Ministri i Punëve të Brendshme
i Republikës së Kosovës

Zenun Pajaziti m.p.